



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

---

## RAPORT SPECIAL NR. 1

### ME REKOMANDIM

drejtuar

Qeverisë së Republikës së Kosovës

- Çështja: Vlerësimi i ligjshmërisë së *nenit 3, paragrafi 3.2, pika (a) të Rregullores për Licencimin e Avokatëve të Huaj, me Ligjin për Avokatinë, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat të Njeriut dhe Lirive Themelore.*
- Palë përgjegjëse: Qeveria e Republikës së Kosovës  
Oda e Avokatëve e Republikës së Kosovës
- Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3; Ligji për Avokatin e Popullit, neni 15 paragrafi 1; Ligji për Avokatinë, neni 28, paragrafi 1.

11 shkurt 2013  
Prishtinë

## *Qëllimi i raportit*

Ky Raport është i bazuar në ankesa individuale dhe burime të tjera të informatave, të cilat i posedon Avokati i Popullit. Raporti analizon pajtueshmërinë e Rregullores për Licencimin e Avokatëve të Huaj, me Ligjin për Avokatinë, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat të Njeriut dhe Lirive Themelore.

## *Përmbledhja e fakteve*

Faktet, në bazë të informatave, të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit, mund të përmblihen si në vijim:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 03-V-085, datë 12 shkurt 2009, ka miratuar Ligjin, Nr. 03/L-117, për Avokatinë.<sup>1</sup>
2. Më 29.10.2011, Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK), bazuar në nenin 39 të Ligjit për Avokatinë, miratoi Rregulloren për Licencimin e Avokatëve të Huaj, e cila ka hy në fuqi të njëjtën ditë.<sup>2</sup>
3. Më 4.1.2013, ankuesit: Fatmir Limaj, Shaban Shala, Arben Krasniqi, Naser Shala, Besim Shurdha, Refki Mazreku, Nexhmi Krasniqi, Sabit Krasniqi, Naser Krasniqi dhe Behlul Limaj,<sup>3</sup> duke konsideruar se ky veprim i Odës së Avokatëve paraqet shkelje të të drejtave të tyre, i janë drejtuar me kërkesë Avokatit të Popullit, që në bazë të kompetencave dhe përgjegjësisë të cilat i janë dhënë me Kushtetutë, të ngritë zërin për shkeljen e të drejtave të tyre.
4. Po ashtu, një ankesë me përmbajtje të njëjtë, lidhur me Rregulloren për Licencimin e Avokatëve të Huaj, më 25.5.2012 e ka paraqitur edhe Shyqri Haxha,<sup>4</sup> shtetas britanik, me banim në Kosovë. Ai kishte një proces gjyqësor dhe nuk kishte mundur ta angazhonte avokatin e tij personal, nga vendi shtetas i të cilit ishte, për ta mbrojtur në procesin gjyqësor që zhvillohej ndaj tij, e që është aktiv ende dhe i papërfunduar. Z. Haxha pohonte se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij, të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ.
5. Ankuesit e lartshënuar konsiderojnë se neni 3, paragrafi 3.2, pika (a) e Rregullores për Licencimin e Avokatëve të Huaj shkel rëndë dy nene të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: nenin 30 – Të Drejtat e Akuzuarit; nenin 31 – E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, e cila i garanton të drejtën e përzgjedhjes së avokatit, për të pasur një gjykim të drejtë dhe të barabartë.
6. Po ashtu, ankuesit e lartshënuar konsiderojnë se si e tillë, kjo Rregullore, respektivisht neni 3, paragrafi 3.2, pika (a), përveç shkeljeve kushtetuese, shkelë edhe nenin 6 paragrafi 3, pika c, e Drejta për një Proces të Rregullt të garantuar me KEDNJ.
7. Ankuesit konsiderojnë se Rregullorja është në kundërshtim me vetë Ligjin për Avokatinë, përkatësisht nenin 6 “Kushtet për regjistrimin në regjistrin e avokatëve”, i cili nuk parasheh kurrfarë kufizime dhe kushte të veçanta për licencimin e avokatëve.

<sup>1</sup> Ligji për Avokatinë, Gazetën Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë; Viti IV/Nr. 49/25 mars 2009.

<sup>2</sup> Rregullorja për Licencimin e Avokatëve të Huaj, Oda Avokateve të Kosovës, në: <http://www.oak-ks.org/ballina-2-0-1> (29.01.2013).

<sup>3</sup> Ankesa nr.13/2013 Limaj dhe të tjerët, rasti regjistruar në Institucionin e Avokatit të Popullit më 22.01.2013, kundër Odës së Avokatëve të Kosovës.

<sup>4</sup> Ankesa nr.222/2012 Haxha, rasti i regjistruar në Institucionin e Avokatit të Popullit më 25.05.2012, kundër Odës së Avokatëve të Kosovës.

8. Në rastin e ankesës Limaj dhe tjerët - rasti Kleçka, ndaj tyre ishte ngritur aktakuza se kanë kryer krime lufte ndaj popullatës civile dhe krime ndaj të burgosurve të luftës, para qershorit të vitit 1999. Procesi gjyqësor zhvillohet nga prokurorët dhe gjyqtarët ndërkombëtarë, të cilët veprojnë në Kosovë, nën mandatin dhe përgjegjësinë e Misionit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX).
9. Po ashtu, edhe në rastin e ankesës së ankuesit Haxhaj (ish-kryeshef i Postës dhe Telekomit të Kosovës), zhvillohet një proces gjyqësor, i cili udhëhiqet nga prokurorët dhe gjyqtarët ndërkombëtarë të EULEX-it.
10. EULEX-i në Kosovë ka kompetenca ekzekutive në sistemin e drejtësisë / prokurorisë/ gjyqësisë dhe e përbëjnë prokurorët dhe gjyqtarët e specializuar për luftimin e krimit për fusha të caktuara me ligj të veçantë.<sup>5</sup>
11. OAK, sipas dokumenteve të publikuara në uebfaqen zyrtare, nuk ka avokat të specializuar për mbrojtjen e qytetarëve për fushat e veçanta të rezervuara për prokurorët dhe gjyqtarët e EULEX-it, ndërsa edhe EULEX-i për Kosovë nuk ka sjellë avokatë të specializuar ndërkombëtarë, por nuk ka as norma që lejojnë angazhimin e tyre.
12. Avokati i Popullit, më 12.4.2012, lidhur me çështjen e ankuesve paraqiti deklaratën në mediat publike, me konstatimin se masa e reciprocitetit, e vendosur nga OAK, për licencimin e avokatëve të huaj që angazhohen në Republikën e Kosovës, përbën shkelje kushtetuese dhe ligjore, pasi i privon qytetarët nga e drejta për zgjedhjen e avokatëve mbrojtës vendorë ose ndërkombëtarë, sipas përzgjedhjes së tyre, të cilën e kanë të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi.<sup>6</sup>
13. OAK, më 12.4.2012, nëpërmjet komunikatës për media, reagoi ndaj deklaratës publike të Avokatit të Popullit, duke konstatuar se avokatia është e pavarur dhe se neni 1, paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit të Avokatisë garantojnë pavarësinë OAK, si organizatë e pavarur publike dhe ka autorizimin për të nxjerrë akte normative për rregullimin dhe organizimin e avokaturës në mënyrë të pavarur.<sup>7</sup>
14. Më 24.9.2012 Avokati i Popullit, priti një delegacion të OAK, të kryesuar nga kryetari i OAK z. Ibrahim Dobruna dhe një ndër çështjet e bisedës ishte edhe Rregullorja për Licencimin e Avokatëve të Huaj. Avokati i Popullit paraqiti bindjen dhe konstatimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, se kufizimet për avokatët e huaj me reciprocitet, si kusht për licencimin e tyre për punë dhe përfaqësim para gjykatave të Kosovës, paraqet kufizim dhe shkelje të të drejtave të njeriut të garantuar me ligje dhe me akte ndërkombëtare, për të gjithë qytetarët e Kosovës.<sup>8</sup>
15. Ankuesit pohojnë se nuk mund të angazhojnë avokatë mbrojtës të specializuar ndërkombëtarë për mbrojtjen në proceset gjyqësore, që zhvillohen për fushat e posaçme të krimit nga prokurorët dhe gjyqtarët e EULEX-it, për shkak të pengesave ligjore, që dalin nga Rregullorja për Licencimin e Avokatëve të Huaj. Në këtë mënyrë atyre mund t'u shkaktohet dëm i pakthyesëm për jetën dhe familjet e tyre.
16. Ankuesit pohojnë se ndihen të pabarabartë në këtë proces gjyqësor, andaj me rastin e paraqitjes së kërkesës/ankesës së tyre kërkuan ndihmën dhe angazhimin e Avokatit të Popullit për pezullimin e zbatimit të kësaj Rregulloreje për të hapur rrugën për të drejtën e zgjedhjes së avokatit mbrojtës, sipas dëshirës.

<sup>5</sup> Baza ligjore, Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 04 shkurt 2008 mbi Misionin për Sundim të Ligjit Evropian në Kosovë, EULEX - KOSOVI, në: <http://www.eulex-kosovo.eu/al/info/whatisEulex.php> (29.01.2013).

<sup>6</sup> "Kosova sot", 12 prill 2012, faqe 5.

<sup>7</sup> Oda e Avokatëve të Kosovës, Komunikatë për media, Prishtinë 12 Prill 2012, Reagim ndaj mendimit të Avokatit të Popullit, z. Sami Kurteshi.

<sup>8</sup> Takimi i Avokatit të Popullit, z. Sami Kurteshi me delegacionin e OAK, në përbërje z. Ibrahim Dobruna, z. Ali Kryeziu dhe znj. Shpresa Rama.

## Mekanizmat ligjorë të zbatueshëm në Republikën e Kosovës

17. Ligji për Avokatinë Nr. 03/L-117, në nenin 6, për regjistrimin e avokatëve mbrojtës të huaj në regjistrin e avokatëve në Republikën e Kosovës, nuk parasheh kurrfarë kufizimi:

*“1. Të drejtë regjistrimi në regjistrin e avokatëve ka secili person që plotëson këto kushte:*

- *të posedojë aftësi për të vepruar;*
- *të jetë rezident i përhershëm i Kosovës;*
- *të ketë të kryer fakultetin juridik;*
- *të ketë përvojë së paku një (1) vjeçare si praktikant Avokature ose praktikant gjykate apo të ketë përvojë dy (2) vjeçare, si praktikant në Administratën Publike;*
- *të ketë të dhënë provimin e judikaturës në Kosovë;*
- *të ketë dhënë betimin solemn;*
- *të mos jetë i dënuar për vepra penale që e bëjnë atë të padenjë për ushtrimin e profesionit të avokatit sipas Kodit të Etikës Profesionale;*
- *të mos jetë i përjashtuar ose i pezulluar nga detyra e gjyqtarit ose prokurorit ose ushtrimi i profesionit të avokatit. Në rastet e përjashtimit kërkesa mund të përsëritet pas pesë vitesh, pas vendimit të plotfuqishëm;*
- *të mos kryejë një veprimtari e cila nuk është në pajtim me profesionin e Avokatit dhe në veçanti veprimtari e cila cenon pavarësinë e tij profesionale.”*

18. Rregullorja për Licencimin e Avokatëve të Huaj e Odës së Avokatëve, në nenin 3 paragrafin 3.2, përcakton kushtet e veçanta për licencim të avokatëve të huaj si në vijim:

*“3.2 Kërkuesi duhet të përfshijë dokumente mbështetëse për të demonstruar se avokati i huaj i plotëson kushtet nga pika 3.1.c):*

*(a) Me kushtet e reciprocitetit, ashtu që me rastin e aplikimit për licencim, avokati i huaj duhet t'i paraqesë Odës dëshmi nga autoriteti kompetent për regjistrimin e avokateve, sipas së cilës avokatët e Republikës së Kosovës mbi baza të njëjta mund të pajisen me licencë të avokatit në vendin nga i cili është aplikanti.*

*(b) Avokatët të cilët deri më tani janë të pajisur me licencë mund ta ushtrojnë profesionin e avokatit të regjistruar në OAK deri më datën 1 janar 2012, sipas kushteve me të cilat janë regjistruar. Deri në datën e cekur duhet ta dëshmojnë reciprocitetin, në të kundërtën do të pason shlyerja ex-officio e tyre nga Regjistri i avokatëve të huaj në OAK[...].”*

19. Kushtetuta e Republikës së Kosovës,<sup>9</sup> në nenin 30 dhe 31 të kapitullit të dytë përcakton; E Drejta e të Akuzuarit është e garantuar dhe çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

*“(1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;*

---

<sup>9</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 30, p.(5) çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat ” të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas...”

- (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;
- (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
- (4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;
- (5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;
- (6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet”.

20. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] përcakton se:

*“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

*Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj. [ ... ]”*

21. Prokuroria Speciale të Republikës së Kosovës<sup>10</sup> (PSRK), sipas nenit 5 të Ligjit, ka kompetencë të veçantë që të hetojë dhe ndjek penalisht krimet, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krim si vijon;

*“[...]*

*d) gjenocidi (neni 116, KPPK);*

*e) krimet kundër njerëzimit (neni 117, KPPK);*

*f) krimet e luftës në kundërshtim të rëndë me konventat e Gjenevës (neni 118, KPPK), krimet e luftës si shkelje e rëndë e ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar (neni 119, KPPK), krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me konventat e Gjenevës (neni 120, KPPK), krimet e luftës të cilat paraqesin shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë në karakterit ndërkombëtar (neni 121, KPPK);*

*g) sulmet në konfliktet e armatosura të një karakteri jo ndërkombëtar kundër instalimeve që përmbajnë forca të rrezikshme (neni 122, KPPK);*

*h) rekrutimi dhe regjistrimi i personave midis moshës pesëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet në konfliktin e armatosur (neni 123, KPPK)[....]”*

22. Prokurorët dhe gjyqtarët e EULEX-it, sipas nenit 3 [Juridiksioni dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në procedurë penale] të Ligjit mbi Kompetencat, për Zgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë,<sup>11</sup> kanë kompetencën për hetimin e të gjitha veprave penale të parapara me Ligjin për Prokurorinë Speciale të Kosovës, por edhe 21 veprat penale të caktuara sipas nenit 3.3.

23. Po ashtu gjyqtarët e EULEX-it sipas neni 3.7. kanë kompetencën që në procedurat penale të gjykojnë në trup gjykues me shumicë të gjyqtarëve ndërkombëtarë.

<sup>10</sup> Ligji nr 03/L-052 për Prokurorin Speciale të Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë Viti III / Nr. 27 / 03 Qershor 2008.

<sup>11</sup> Ligji nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, për Zgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: VITI III / Nr. 27 / 03 Qershor 2008.

*“3.1 Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në procedurë penale do të kenë juridiksion dhe kompetencë për çdo lëndë të hetuar a të ndjekur penalisht nga PSRK-ja”.*

*“3.7 Kolegjet në të cilat gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë juridiksionin e tyre në procedurat penale do të përbëhen me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it dhe do të kryesohen nga gjyqtarët e EULEX-. Sidoqoftë, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të ketë kompetencë, me përjashtim të kësaj rregulle dhe për arsye të bazuara, që të vendosë që kolegji të ketë përbërje shumicë apo të plotë të gjyqtarëve vendor ose mund të vendosë që të mos caktojë fare gjyqtarët e EULEX-it për fazat e posaçme të procedurës.”*

24. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ)<sup>12</sup> është dokument ligjor i zbatueshëm drejtpërdrejtë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës<sup>13</sup> dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Neni 6 paragrafi 3 i KEDNJ e drejta për një proces të rregullt, garanton të drejtat minimale të të akuzuarit si në vijim:

*“Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*

- *të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;*
- *t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;*
- *të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;*
- *të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;*
- *të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq”.*

## **Analiza juridike**

25. Rregullorja për Licencimin e Avokatëve të Huaj nuk ka të drejtë të prekë normën e kontratës shoqërore në relacion me të tjerët, sidomos jo me të mbrojturit. Qëllimi i saj duhet të jetë rregullimi i brendshëm i Odës së Avokatëve, por jo edhe rregullimi ligjor i ndonjë të drejte të klientëve. Në këtë rast masa e reciprocitet përbën një kufizim pa ndonjë delegim shprehimor ligjor për rregullimin e relacionit avokat mbrojtës - klient. Me reciprocitetin në rregulloren aktuale Oda e Avokatëve nuk i përmbahet frymës së delegimit ligjor, përcaktimit të kriterëve profesionale dhe me këtë garantimit të kualitetit profesional

26. Avokati i Popullit, bazuar në faktet përmbledhëse të rastit dhe mekanizmat ligjorë të zbatueshëm në Republikën e Kosovës, vëren se legjislacioni sekondar i nxjerrë nga Oda e Avokatëve, mbi bazën e Ligjit për Avokatinë, për rregullimin e licencimit të avokatëve të huaj, tejkalon normat dhe dispozitat ligjore të vetë ligjit bazik, përkatësisht shkelë parimin e ligjshmërisë, i cili bazohet në harmonizimin e normave dhe në bazueshmërinë e tyre në ligj. Ndër parimet kryesore të ligjshmërisë është

<sup>12</sup> Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e miratuar në Romë, 4.XI.1950, neni 6” **E drejta për një proces të rregullt”.**

<sup>13</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22 Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare.

*Parimi i supremacionit të ligjit ndaj akteve të tjera juridike dhe të gjitha aktet me fuqi nënligjore duhet të jenë në pajtim me ligjin.*

27. Nga analiza e Ligjit për Avokatinë, në nenin 6, vërehet se ligji që në mënyrë shprehimore përcakton kushtet për regjistrimin e avokatëve,<sup>14</sup> nuk parasheh kurrfarë kufizimi, përkatësisht sa i përket regjistrimit të avokatëve (shih pika 17 e këtij rekomandimi). Ky nen nuk përmban norma për kushte të veçanta për licencimin e avokatëve të huaj.
28. Po ashtu, ky ligj as në dispozitat përkufizuese e as në nenet e tjera, nuk përmban norma me të cilat do të sqarohet se çka përfshin nocioni “avokat”, avokat vendor apo edhe i huaj. Meqenëse ligji nuk përmban këtë përkufizim, mund të konstatohet se ligjvënësi me këtë nuk ka bërë dallimin avokat vendor apo avokat i huaj, dhe as ka përcaktuar kushte të veçanta për ushtrimin e profesionit të avokatit në nenin 6.
29. Rregullorja për Licencimin e Avokatëve të Huaj e Odës së Avokatëve, në nenin 3 paragrafin 3.2 përcakton kushtet e veçanta për licencim të avokatëve të huaj, pa pasur autorizimin e ligjit bazik, si në vijim:

*“3.2 Kërkuesi duhet të përfshijë dokumente mbështetëse për të demonstruar se avokati i huaj i plotëson kushtet nga pika 3.1.c.):*

*(a) Me kushtet e reciprocitetit, ashtu që me rastin e aplikimit për licencim avokati i huaj duhet odes ti paraqes dëshmi nga autoriteti kompetent për regjistrimin e avokateve sipas se cilit avokatet e Republikës së Kosovës mbi baza të njëjta mund të pajisen me licence të avokatit në vendin nga i cili është aplikanti.*

30. Avokati i Popullit vëren se neni 3 paragrafi 3.2. (a) i Rregullores për Licencimin e Avokatëve të Huaj, është në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit të Avokatisë, pasi kushtet për regjistrimin përkatësisht të licencimit për ushtrimin e profesionit të avokatisë, janë të përcaktuara me nenin 6 të ligjit. Vetë ligji i ka përcaktuar kushtet bazike të regjistrimit të avokatisë dhe nuk ka ndonjë normë në këtë ligj i cili lejon, autorizon apo bartë të drejtën për nxjerrje të normave ligjore, tek ndonjë subjekt juridik i caktuar, për caktimin e kushteve të veçanta për licencimin e avokatëve.
31. Parim në hartimin e ligjeve dhe qëllimi themelor i ligjit është se, vetëm ligji ka autoritetin për përcaktimin të drejtave dhe detyrimeve për personat juridik dhe fizik. Vetëm në raste të veçanta, vetë ligji në mënyrë shprehimore delegon të drejtën për rregullimin e çështjeve konkrete me akte nënligjore. Ndërsa legjislacioni sekondar nxirret vetëm për zbatimin e legjislacionit primar (ligjit), por jo edhe për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve, që bien ndesh me vetë normat e ligjit.
32. Në rastin konkret, Avokati i popullit konstaton se neni 3 paragrafi 3.2 (a) i Rregullores për Licencimin e Avokatëve të Huaj, është në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit për Avokatinë. Sepse përveç që Ligji për Avokatinë shprehimisht nuk e bën kufizimin përmes reciprocitetit, të drejtën për një kufizim të tillë nuk e delegon as tek Rregullorja në fjalë. Prandaj, këtu kemi të bëjmë me cenimin e parimit të ligjshmërisë, pasi që rregullorja është në kundërshtim me ligjin bazik.
33. Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit - EULEX-i që vepron në Kosovë, e përkrah Kosovën në rrugën drejt integritimeve evropiane dhe në fushën e sundimit të ligjit. Ky mision, përveç të tjerash, në “sektorin ekzekutiv“ heton, ndjek penalisht dhe gjykon raste të ndjeshme, duke i përdorur funksionet e tij ekzekutive.
34. Kompetencat e sektorit ekzekutiv të EULEX-it janë të veçanta. Ato janë të parapara me dy ligje bazike: Ligji mbi Kompetencat për Zgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë dhe; Ligji për

<sup>14</sup> Po aty, neni 6.

Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Sipas këtyre ligjeve bazike, prokurorët dhe gjyqtarët e EULEX-it, kanë kompetencë të veçantë të hetojë dhe të ndjekë penalisht krimet më të rënda si:

“[...]

- gjenocidi (neni 116, KPPK);
- krimet kundër njerëzimit (neni 117, KPPK);
- krimet e luftës në kundërshtim të rëndë me konventat e Gjenevës (neni 118, KPPK);
- krimet e luftës si shkelje e rëndë e ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar (neni 119, KPPK);
- krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me konventat e Gjenevës (neni 120, KPPK);
- krimet e luftës të cilat paraqesin shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë në karakterit ndërkombëtar (neni 121, KPPK);

[...]”

35. Me qëllim të ushtrimit të kompetencave ligjore, në fushën penale, sipas këtyre ligjeve bazike (shih pikën 21 dhe 22 të këtij rekomandimi), misioni i EULEX-it në Kosovë ka sjellë gjyqtarë dhe prokurorë me përvojë, të specializuar dhe të profilizuar për luftimin e krimeve në fushën penale, por jo edhe avokatë mbrojtës për këto fusha.
36. Avokati i Popullit konstaton se proceset gjyqësore të zhvilluara nga prokurorët dhe gjyqtarët e EULEX-it, do të mund të vënë në pozitë të pabarabartë para ligjit palët ndaj të cilëve zhvillohen procese hetimore dhe gjyqësore, për shkak të mungesës përkatësisht të pamundësisë ligjore me ligjet e Kosovës, për angazhimin e avokatëve ndërkombëtarë të specializuar dhe me përvojë për fushat e caktuara penale, që janë kompetencë e veçantë e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it – “Barazia e armëve”.
37. Avokati i Popullit e vlerëson qëllimin nenit 2 paragrafi 2.4 të Ligji mbi Kompetencat, për Zgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, i cili përveç të tjerash parasheh që prokurorët dhe gjyqtarët e EULEX-it, gjatë ushtrimit të funksioneve gjyqësore, në përputhje me dispozitat e neneve 3,4 dhe 5 të këtij ligjit, monitorojnë, udhëzojnë dhe këshillojnë gjyqtarët kosovarë.
38. Këshillat dhe udhëzimet e ofruara nga përvoja dhe njohuritë profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, është më se e mirëseardhur për ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve vendorë në sistemin e gjyqësorit. Por, shqetësimi është se përvojat dhe njohuritë ndërkombëtare për avokatët vendorë nuk i ka paraparë ligji dhe kjo palët/mbrojtësit i vë në pozitë të pabarabartë profesionale në proceset gjyqësore.
39. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh faktin se nga viti 2008 (shpallja e pavarësisë) dhe periudha paraprake UNMIK-ut nga viti 1999, kemi një traditë dhe përvojë të paktë ligjore dhe juridike në sistemin e drejtësisë/gjyqësisë në raport me shtetet përkatësisht gjyqtarët dhe prokurorët prej nga vijnë.
40. Me gjithë konsideratën, në fushën e avokatisë kosovare nuk mund të konstatohet se kemi specializime të avokatëve për fushat e veçanta të krimit, veprave penale të cilat janë në kompetencë të veçantë të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, të cilët do



të kishin përgatitjen dhe përvojën profesionale për mbrojtjen e palëve/klientëve në proceset gjyqësore.<sup>15</sup>

41. Avokati i Popullit, më tej vëren që parashtruesit e ankesave nuk kanë mundësi të autorizojnë një avokat ndërkombëtar për t'i mbrojtur në proceset penale, të cilat zhvillohen sipas akuzës së ngritur nga prokurorët/gjyqtarët e EULEX-it (rasti i ashtuquajtur "Kleçka", sipas të cilit akuzohen për krime të luftës në Kosovë, para muajit qershor 1999). Pengesat që pamundësojnë përzgjedhjen e avokatit, sipas përzgjedhjes së të akuzuarve, gjenden në Rregulloren për Licencimin e Avokatëve të Huaj të Odës së Avokatëve, neni 3, paragrafi 3.2 (a), ku përcaktohen kushtet e veçanta për licencimin e avokatëve të huaj.
42. Avokati i Popullit konsideron se *neni 3, paragrafi 3.2, pika (a)* i Rregullores për Licencimin e Avokatëve të Huaj është në kundërshtim me dy nene të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], e cila i garanton të drejtën e përzgjedhjes së avokatit, për një gjykim të drejtë dhe të barabartë.
43. Si e tillë, kjo rregullore, respektivisht neni i lartpërmendur, përveç shkeljeve kushtetuese, shkel edhe nenin 6 paragrafi 3, pika c, e Drejta Për Një Proces të Rregullt të garantuar me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Neni 6 paragrafi 3, pika c i KEDNJ-së shprehimisht i garanton të akuzuarit që të mund:  
*"c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;"*
44. Edhe neni 30 paragrafi 5 [E Drejta e të Akuzuarit], i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton shprehimisht të drejtën e të akuzuarit që:  
*"(5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;"*
45. Avokati i Popullit vëren se Kushtetuta dhe normat ligjore në Republikën e Kosovës, si dhe KEDNJ, u garantojnë të akuzuarve që, veçanërisht në çështjet penale, të kenë një mbrojtës, sipas zgjedhjes së tyre, në mënyre që ata të jenë të përfaqësuar në mënyre të duhur dhe efektive, para së gjithash, për t'i siguruar interesat e tyre dhe interesat e administrimit të mirëfilltë të drejtësisë.
46. E drejta e përzgjedhjes së avokatit mbrojtës siguron edhe respektimin e parimit të "barazisë së armëve", që do të thotë se të gjithë palëve u jepet mundësia për të prezantuar çështjen tyre në kushte të barabarta, në mënyrë që të mos vihen në disavantazh të përballë kundërshtarëve të tyre.
47. Pamundësimi i përzgjedhjes së avokatit mbrojtës me përgatitje dhe përvojë profesionale adekuate në proceset penale, të zhvilluara dhe të udhëhequra nga prokurorët dhe gjyqtarët ndërkombëtarë me kompetenca të veçanta për veprat penale të veçanta, definitivisht mund të cenojë parimin e barazisë së armëve në një proces gjyqësor ku ndahet drejtësia.
48. Avokati me tej vëren se, kufizimet që bëhen lidhur me përzgjedhjen e avokatit, sipas përzgjedhjes së të akuzuarve për t'i mbrojtur në procesin gjyqësor penal, shkel të drejtën për gjykim të drejtë, e cila garantohet me nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ.

---

<sup>15</sup> Shih uebfaqen e Odës së Avokatëve të Kosovës, <http://www.oak-ks.org/> (30/01/2013), Lista e Avokatëve, nuk përmban specializimet e avokatëve.

49. Po ashtu, norma kufizuese e reciprocitetit për licencimin e avokatëve të huaj, sipas Rregullores për Licencimin e Avokatëve të Huaj të Odës së Avokatëve, bie ndesh me aktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe ligjet vendore të cituara më lart, dëmton drejtpërdrejtë interesat, të drejtat themelore të qytetarëve dhe interesat e tyre në proceset gjyqësore penale dhe civile që zhvillohen nga gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar.
50. Nëse qëllimi i parimit “barazia e armëve” në vetvete përmban qëllimin që palët ndërgjygjëse vërtet të jenë të barabarta, ndërsa të gjitha subjektet e përfshira në një proces gjyqësor: gjykatësi/t, prokurori/ët dhe avokati/ët mbrojtës, si objekt trajtimi kanë vetëm të akuzuarin/t dhe të mbrojturin/t, kjo medoemos kërkon që subjektet ndërgjygjëse të jenë të barabarta. Në rastin konkret, derisa në njërin anë kemi të bëjmë me gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë, me kompetenca të veçanta dhe shtesë, të specializuar për vepra dhe fusha të veçanta, që janë objekt trajtimi në një proces gjyqësor, nëse respektohet parimi i “barazisë së armëve”, në një proces gjyqësor, kjo medoemos kërkon edhe avokatë mbrojtës të specializuar, po për veprat dhe fushat që janë objekt trajtimi. Në rastin konkret kjo pamundësohet pikërisht me Rregulloren për Licencimin e Avokatëve të Huaj të Odës së Avokatëve në Republikën e Kosovës.
51. Rregullorja për Licencimin e Avokatëve të Huaj të Odës së Avokatëve, me parimin e *reciprocitetit* të integruar në nenin 3 paragrafi 3.2 (a) të Rregullores për Licencimin e Avokatëve të Huaj, është në kundërshtim edhe me parimin e drejtësisë distributive, e cila për objekt mund të ketë vetëm avokatët mbrojtës, të drejtat dhe obligimet e tyre, por jo edhe të drejtat e të akuzuarit, të garantuara me Kushtetutë dhe me ligj dhe me normat ndërkombëtare universale dhe rajonale për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
52. Si në çdo rast tjetër, edhe këtu drejtësia kërkon që çdo person të përmbahet nga ndonjë përparësi arbitrare, qoftë ajo përparësi shoqërore apo natyrore, në marrëdhëniet me të tjerët, madje edhe në rastet kur ky person është i sigurt se të tjerët nuk do të veprojnë kështu për ta respektuar atë, sepse drejtësia nuk është asgjë tjetër, përveç se mungesa e pabarazive moralisht arbitrare dhe detyrim i çdo personi është që të përpiqet me çdo kusht të minimizojë pabarazitë e tilla deri në kufijtë e mundësive të personale. Në rastin konkret, kemi madje një rast edhe më të rëndë. Pabarazia e institucionale apo profesionale, në raportet midis avokatëve vendës dhe atyre ndërkombëtarë, nuk guxon të përkthehet në cungimin e të drejtave të të akuzuarve në Republikën e Kosovës për mbrojtje adekuate profesionale. Në këtë rast, rregullimi i marrëdhënieve midis avokatëve mbrojtës vendës dhe atyre ndërkombëtarë, apo me fjalë të tjera, barra e rregullimit të tregut të avokatisë në Republikën e Kosovës në asnjë mënyrë nuk duhet të bartet mbi supet e të të akuzuarve apo të të mbrojturve, qoftë madje edhe me kushtin e humbjeve financiare që do të pësonin avokatët mbrojtës vendës në këtë rast.
53. Norma shoqërore e reciprocitetit, si përgjigje e natyrshme ndaj sjelljes së të tjerëve, përmban në vete tendencën për kufizimin e gatishmërisë së njerëzve për të respektuar kërkesën themelore të drejtësisë, edhe pse duket sikur reciprociteti është një pjesë embrionale e drejtësisë. Shikuar në aspektin e drejtësisë distributive, kërkesa për një pritje racionale të reciprocitetit më shumë e kufizon dëshirën e njeriut racionale për të vepruar në përputhje me kërkesën thelbore të drejtësisë sesa të jetë një nga tiparet përbërëse të saj. Dhe, pikërisht, duke pasur parasysh këtë prirje të njeriut racionale, ligjvënësit kosovarë, as në Kushtetutë dhe as tek ligjet në fuqi, në Republikën e Kosovës, nuk e kanë paraparë parimin e reciprocitetit, si normë për rregullimin e marrëdhënieve midis avokatëve mbrojtës dhe ndërkombëtarë.
54. Avokati i Popullit, bazuar në analizën ligjore të mësipërme, si dhe në kompetencat ligjore dhe kushtetuese, në cilësinë e rekomanduesit për Qeverinë e Republikës së

Kosovës, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, ka për qëllim përmirësimin e përmbajtjes së dispozitave të Rregullores për Licencimin e Avokatëve të Huaj. Prandaj, Avokati i Popullit, në bazë të nenit 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 15 paragrafi 1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, në mbështetje të nenit 28, paragrafi 1, të Ligjit për Avokatinë, i:

### **Rekomandon**

#### **Qeverisë së Kosovës**

- **Të pezullojë, për afat të pacaktuar, më së voni deri në momentin e angazhimit të prokurorëve dhe gjykatësve ndërkombëtarë në gjyqësinë e Republikës së Kosovës, ekzekutimin e nenit 3, paragrafi 3.2, pika (a) të Rregullores për Licencimin e Avokatëve të Huaj, si të papajtueshëm me nenin 6 të Ligjit për Avokatinë, nenin 30 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 paragrafi 3, pika c, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.**

Në pajtim me nenin 135 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 26 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 03/L-195, Ju lutemi që të na informoni për veprimet që do të ndërmerret Qeveria e Republikës së Kosovës, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimit të lartpërmendur.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunim, Ju lutem që përgjigjen tuaj, në lidhje me këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm ligjor, por jo më shumë se tridhjetë (30) ditë.

Me nderime,

Sami Kurteshi

Avokat i Popullit

**Bashkëngjitur:** - Ligji Nr. 03/L-117, për Avokatinë  
- Rregulloren për Licencimin e Avokatëve të Huaj , 29.10.2011.

**Kopje:** - Odës së Avokatëve të Republikës së Kosovës;  
- Kryetarit të Asamblesë të Gjyqtarëve të EULEX-it;  
- Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut;  
- Ankuesve;  
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës;  
- Këshillit Prokurorial të Kosovës;  
- Gjykatës Supreme të Kosovës.